



PROCESVERBALI

Nga mbledhja e parë e jashtëzakonshme e Kuvendit Komunal të Graçanicës

E mbajtur më datën 17.05.2024 në sallën e Kuvendit të Komunës së Graçanicës dhe filloi me punë në orën 13:00.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Graçanicës, Millan Dimitrijeviq, hapi mbledhjen duke i përshëndetur të gjithë të pranishmit dhe shtoi se në mbledhje nga 19 asamblistë janë të pranishëm 17 asamblistë dhe ka kuorum, ndërsa mungojnë 2 asamblistë: Sllagjana Rashiq dhe Dragan Maksimoviq. Në mbledhje janë të pranishëm edhe përfaqësuesit e KFOR-it, përfaqësuesit e OSBE-së, mediat, Shërbimi i Informimit dhe Shërbimi për Çështjet e Kuvendit.

Kryesuesi i njoftoi asamblistët se para mbledhjes së sotme të Kuvendit u mbajt mbledhja e parë e jashtëzakonshme e Komitetit për Politikë dhe Financa si dhe se Komiteti njëzëri dha mendimin pozitiv për rendin e ditës së caktuar për mbledhjen e sotme të Kuvendit.

Kryesuesi tha se mbledhja e sotme është caktuar për shkak të afatit ligjor prej 30 ditësh për shqyrtimin e kërkesës së MAPL-së për rishqyrtimin e Rregullores nr.03/18/KG, e cila është dorëzuar kryetarës të komunës dhe kryesuesit të KK.

Kryesuesi i Kuvendit tha se në bazë të nenit 44 të Ligjit nr.03/L-040 për vetëqeverisjen lokale është caktuar rendi i mëposhtëm i ditës:

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e katërt e rregullt, e mbajtur më datën 29.04.2024.
2. Shqyrtimi i kërkesës së Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal për rishqyrtimin e Rregullores nr.03/18/KG mbi kushtet e përgjithshme për parcelim, rregullat dhe procedurën e ndërtimit të objekteve dhe lëshimin e kushteve ndërtimore për ndërtesat nën kompetencën e komunës.
3. Të ndryshme.

Kryesuesi i Kuvendit hapi diskutimin për pikën e parë të rendit të ditës:

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e katërt e rregullt, e mbajtur më datën 29.04.2024.

Pas votimit, kryesuesi konstatoi se Kuvendi njëzëri, me votat e 17 asamblistëve "Pro", miratoi pikën e parë të rendit të ditës.

Kryesuesi i Kuvendit hapi diskutimin për pikën e dytë të rendit të ditës:

2. Shqyrtimi i kërkesës së Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal për rishqyrtimin e Rregullores nr.03/18/KG mbi kushtet e përgjithshme për parcelim, rregullat dhe procedurën e ndërtimit të objekteve dhe lëshimin e kushteve ndërtimore për ndërtesat nën kompetencën e komunës.

Kryesuesi tha, se para 30 ditësh ai dhe kryetarja e komunës kanë pranuar një kërkesë nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL), e cila thirret në raportin e Ministrisë së Ambientit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MAPHI), ku thuhet se në kërkesën e disa qytetarëve, të cilët kanë paraqitur kundërshtime, në të cilat ne nuk kemi pasur qasje dhe as që dikush na i ka dorëzuar ato, kanë kërkuar që neni i kontestuar i ligjit të shfuqizohet pa asnjë shpjegim në Rregulloren nr. 03/18/KG lidhur me ndërtimin. Ata e kanë dërguar kërkesën në gjuhën shqipe, ndërsa ne kemi kërkuar nga Ministria që ta marrim përkthimin në gjuhën serbe, por për 30 ditësh ne nuk kemi pranuar asnjë përgjigje, kështu që kryetarja e komunës ka propozuar që kjo kërkesë të shqyrtohet, edhe pse rregullorja është në përputhje me Ligjin e Kosovës, e cila është miratuar në vitin 2018 dhe e cila është publikuar në Gazetën zyrtare të Kosovës, është në fuqi dhe nuk është absolutisht e kundërligjshme.

Asamblisti Ljubisha Karaxhiq, para partisë "SRPSKA", tha se nuk dyshon në deklarinimin e kryesuesit, por është dashur që në mbledhje të jetë i pranishëm edhe juristi i cili do të thoshte nëse rregullorja është në kundërshtim me ligjin. Rregullorja nuk është në kundërshtim me ligjin. Në vitin 2018, unë kam qenë kryesues i Kuvendit të Komunës së Graçanicës dhe në atë kohë Rregullorja është miratuar nën kontrollë strikte dhe rigorozë të Ministrisë së Pushtetit Lokal, e cila më pas është publikuar në Gazetën zyrtare e Kosovës si e vlefshme.

Kryesuesi tha se i ka njoftuar asamblistët e Kuvendit se ministri i MAPL-së, z. Krasniqi, shumë herë e ka akuzuar Kuvendin dhe Komunën e Graçanicës lidhur me disa çështje që nuk kanë të bëjnë me të vërtetën, pa konfirmime dhe në fund kur e ka pranuar mohimin nga Kuvendi Komunal i Graçanicës as që denjoi të kërkonte falje. Prandaj, nuk pres që do të marrim ndonjë përgjigje lidhur me ndonjë gjë nga MAPL-ja. Ne duhet ta respektojmë afatin prej 30 ditësh. Ne si asamblistë të përzgjedhur nga qytetarët duhet të vendosim a do ta pranojmë këtë apo jo. Qëndrimi im pajtohet me tuajin dhe unë kam qenë asamblist në atë mandat kur është miratuar rregullorja dhe çdo akt i miratuar këtu kontrollohet nga MAPL-ja dhe ata e vlerësojnë ligjshmërinë e tij. Duke pasur parasysh se ata nuk kanë pasur asnjë vërejtje dhe është publikuar në Gazetën zyrtare të Kosovës, konsiderohet se ky është një presion thjesht politik dhe një përpjekje për të centralizuar absolutisht gjithçka, përkatësisht që një numër i madh i rregullave të transferohet nga qeverisja lokale deri tek pushteti qendror.

Asamblisti Dejan Jevtiq, para partisë "SRPSKA", tha se Kuvendi i komunës është autoritet legjislativ dhe miraton akte për të gjitha komunitetet pa dallim kombësie dhe mendoj se duhet të jemi të unifikuar. Jam pro refuzimit të kërkesës së MAPL-së.

Asamblisti Granit Gashi, para partisë "ALIANCA SHQIPTARE", tha se MAPL-ja ka kërkuar nga Ministria e Ambientit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MAPHI) rishqyrtimin e këtij akti. Më 11 prill, MAPHI-ja është përgjigjur se kjo Rregullore është e

kundërligjshme dhe ka dhënë një afat prej 30 ditësh për shfuqizimin e saj. Para kësaj, në vitin 2019 dhe 2020 kjo Rregullore është ndryshuar dhe plotësuar dy herë dhe për të dyja ndryshimet Kuvendi është detyruar që t'i shfuqizojë ato vendime. Kjo rregullore është e kundërligjshme sepse ua pamundëson qytetarëve që t'i marrin lejet ndërtimore. Kam një pyetje për ju: "Në sa raste komuna ka pranuar kërkesa nga qytetarët, ku ata ua kanë dhuruar komunës parcelat e tyre për ta riemërtuar parcelën në rrugë? Sa kërkesa të të njëjtit lloj keni pranuar për këmbimin e parcelave në mënyrë që të ndërtohet rruga? Unë këto kërkesa i kam paraqitur edhe më herët në komunë, por kurrë nuk kam pranuar asnjë përgjigje. Në vitin 2018 keni votuar për vendimin me të cilin keni tentuar ta ndryshoni strukturën demografike, ku keni dashur t'ia jepni Komunës së Fushë Kosovës vendbanimet Marigona dhe Uglar. Keni ndërmarrë masa që janë diskriminuese ndaj qytetarëve. Me këtë kërkesë nuk është kërkuar nga ne që ta shprehim mendimin tonë, as të diskutonim, por na urdhëruan që ta vëmë jashtë fuqisë, për arsye se është e paligjshme. Nëse kjo Rregullore nuk vihet jashtë fuqisë, atëherë unë do t'i drejtohem Gjykatës Kushtetuese për vlerësimin e ligjshmërisë së Rregullores. "Koha do të tregojë nëse Rregullorja do të shfuqizohet sot ose pas një kohe".

Kryesuesi tha se nëse do të kishit qenë i rregullt në mbledhjet e Kuvendit Komunal të Graçanicës dhe do të kishit qëndruar deri në përfundim të mbledhjeve, që është obligim i juaji, mund të kishit marrë përgjigje ndaj këtyre pyetjeve. Kuvendi nuk ka pranuar asnjë nga kërkesat që ju po përmendni, ndërsa ju nuk më jeni drejtuar asnjëherë as zyrtarisht as jozyrtarisht në lidhje me këto probleme. Nëse Rregullorja do të ishte e paligjshme në atë kohë, MAPL-ja nuk do ta kishte pranuar atë dhe as nuk do të ishte e publikuar në Gazetën zyrtare të Kosovës. Lidhur me konstatimin tuaj se ne donim ta ndryshonim strukturën e popullsisë, mund të them vetëm se kjo që po thoni është tejet hipokrite, sepse ne këtu nuk mund ta ndryshojmë strukturën e popullsisë dhe as nuk kemi pushtet në nivel qendror. Ne punojmë ekskluzivisht sipas ligjit, këtu tek ne, në Komunën e Graçanicës, vendos shumica, sepse secili asamblist prapa vetes ka qytetarë që e kanë votuar dhe secili mban përgjegjësi, për dallim nga disa komuna të tjera, ku 15, 20 apo 50 veta kanë votuar për të gjithë sesionin e komunës dhe vendoset në bazë të 100 apo 200 votave në emër të 10.000, 15.000 dhe 20.000 mijë banorëve. Dhe po shoh që kjo nuk po i pengon askujt në pushtetin qendror. Këtu është krejtësisht ndryshe. Edhe ju jeni në këtë pozitë sepse keni fituar besimin e qytetarëve të Komunës së Graçanicës. A është ligji diskriminues apo jo, nuk mund t'ju them, supozoj nëse e pyesni MAPL-në, e cila duhet të na i dërgojë të gjitha kërkesat e saj në gjuhën zyrtare serbe dhe e cila refuzon ta bëjë këtë, atëherë sipas tyre ai mund të jetë diskriminues. Secili akt që është diskriminues, ju më thoni, ju jeni jurist, nuk besoj se do të ishte në Gazetën zyrtare të Kosovës. Ju keni të drejtë të shkoni përpara, por nuk keni të drejtë ta trembni askënd këtu, sepse askush nuk ka frikë as nga ju dhe deklaratat tuaja, e as nga dikush tjetër. Kjo është një paradë për mediat në mënyrë që ju z. Gashi të tregoheni dikushi politikisht. Unë ju këshilloj që për çdo gjë të kërkonim me shkrim dhe të jeni prezent deri në fund në mbledhjet tona të Kuvendit, në të cilat marrin pjesë drejtorët, ku mund t'ua bëni atyre pyetjet e drejtpërdrejta dhe të merrni një përgjigje po ashtu të drejtpërdrejtë prej tyre. Nuk do ta thelloja

më tej diskutimin me ju, nuk është as vendi dhe as koha dhe gjithçka që kërkon ligjërisht, do ta merrni brenda afatit ligjor.

Asambleti Granit Gashi, para partisë “ALIANCA SHQIPTARE”, kërkoj fjalën dhe tha se kryesuesi e ka sulmuar personalisht.

Kryesuesi tha se nuk e ka sulmuar, por vetëm është përgjigjur.

Kryesuesi hodhi në votim shqyrtimin e kërkesës së Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal për rishqyrtimin e Rregullores nr.03/18/KG mbi kushtet e përgjithshme për parcelim, rregullat dhe procedurën e ndërtimit të objekteve dhe lëshimin e kushteve ndërtimore për ndërtesat nën kompetencën e komunës, përkatësisht shfuqizimin e Rregullores nr.03/18/KG.

Pas votimit, kryesuesi konstatoi se Kuvendi, me 1 votë “Pro” të asamblistit Granit Gashi dhe 16 vota “Kundër” të asamblistëve, nuk e miratoi pikën e dytë të rendit të ditës dhe nuk e shfuqizoi Rregulloren nr.03/18/KG.


Kryesuesi i Kuvendit hapi diskutimin për pikën e tretë të rendit të ditës:

3. Të ndryshme.

Pasi që askush nuk e mori fjalën për të diskutuar lidhur me pikën “Të ndryshme” të rendit të ditës, kryesuesi falënderoi për bashkëpunim dhe mbledhja mbaroi në orën 13:25.

Procesmbajtësi:

Agron Karadollami



Kryesuesi i Kuvendit Komunal



Milan Dimitrijević